RrGK ndërmori disa iniciativa për të rritur ndërgjegjësimin e institucioneve dhe akterëve, duke përfshirë përdorimin e platformës së konsultimit publik për të komentuar legjislacionin parësor dhe dytësor në lidhje me rregulloret e punës. Përveç ligjeve dhe politikave të lartpërmendura që tani përfshijnë një perspektivë të përmirësuar gjinore pas avokimit të RrGK-së, RrGK dërgoi gjithashtu të dhëna në Zyrën e BE-së në Kosovë për të informuar kapitullin e Politikës Sociale dhe Punësimit të Raportit të KE-së për Kosovën 2023.

RrGK u takua gjithashtu me akterët kryesorë të përfshirë në politikatat e punës, duke lehtësuar diskutimet në mes të Forumit Ekonomik të Grave, koalicionit jozyrtar i grupeve kryesore të ekspertëve dhe OShC-ve¹, dhe Zyrës së Kryeministrit për PVGJ-të dhe mospërputhjet ndërmjet ligjit të punës të Kosovës dhe standardeve të BE-së. Përmes avokimit RrGK dhe Forumi theksuan nevojën e ndryshimit të ligjit për të avancuar barazinë gjinore në punë.

¹ Forumi Ekonomik i Grave (FEG) përfshin këto organizata: RrGK-në, Institutin Riinvest, Demokracia për Zhvillim (D4D), Qendrën Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj), Rrjetin e Grave Rome, Ashkalike dhe Egjiptiane të Kosovës (RROGRAE), Kosova – Women 4 Women, Institutin GAP, Qendrën për Informim, Kritikë dhe Aksion (QIKA) dhe Iniciativën Kosovare për Stabilitet (IKS)



Më tej, RrGK përdori letrat avokuese për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të nxitur ndryshimet e politikave. Këto letra artikulojnë sfidat me të cilat përballen gratë në tregun e punës për shkak të barrierave ekzistuese ligjore dhe jepnin rekomandime për reforma. Duke u angazhuar drejtpërdrejt me politikëbërësit dhe vendimmarrësit përmes këtyre letrave avokuese, RrGK dhe partnerët e saj tërhoqën vëmendjen për urgjencën e harmonizimit të legjislacionit të punës me kornizën ligjore të BE-së, veçanërisht në lidhje me lejen e lehonisë, atësisë dhe pushimit prindëror sipas Direktivës së BE-së për balancën mes punës dhe jetës.

Institucionet dhe akterët kryesorë janë më të vetëdijshëm për shkallën e diskriminimit me bazë gjinore në punë në Kosovë dhe mënyrat për ta trajtuar atë

RrGK vazhdoi ngritjen e vetëdijes për përhapjen e diskriminimit me bazë gjinore në punë përmes përafërsisht 18 përpjekjeve avokuese drejt BE-së dhe qeverisë. Gjatë takimeve me zyrtarët e BE-së, RrGK kërkoi një perspektivë të përmirësuar gjinore në Raportin e KE-së për Kosovën 2023 lidhur me shkeljet e të drejtave të punës, si dhe e ngriti këtë çështje gjatë takimit të Nënkomisionit të MSA-së për Politikë Sociale dhe Punësim. RrGK avokoi për përmirësimin e adresimit të diskriminimit me bazë gjinore duke harmonizuar ligjet ekzistuese dhe duke përmirësuar mekanizmat për raportimin e tij dhe ngacmimet seksuale në punë. RrGK e theksoi këtë çështje në gjetjet paraprake të analizës së saj gjinore të digitalizimit të përbashkët me palët e interesuara të BE-së dhe qeverisë.



Përmirësimi i qasjes në drejtësi në rastet e diskriminimit me bazë gjinore në punë dhe shkeljeve të të drejtave të grave në punë

Edhe pse rastet janë referuar në vitet e mëparshme dhe RrGK ka kërkuar mbështetje financiare (pa sukses) për të mbështetur rastet e tjera, asnjë rast i tillë nuk është referuar në vitin 2023.

Rritja e ndërgjegjësimit për ekonominë informale dhe si ta trajtojmë atë duke përdorur një qasje të përgjegjshme gjinore

RrGK filloi hulumtimin për analizën e saj gjinore të ekonomisë joformale, të mbështetur nga BE-ja dhe Suedia me kontributin e UNFAO përmes një nisme sinergjike. I pari i këtij lloji në Kosovë dhe në pjesën më të madhe të rajonit, ky hulumtim synonte t'i ofronte qeverisë rekomandime konkrete për të informuar Strategjinë e ardhshme për të adresuar informalitetin, duke siguruar një qasje të përgjegjshme gjinore "mos dëmto". Analiza do të informojë avokimin në të ardhmen, duke rritur ndërgjegjësimin për ekonominë informale dhe mënyrën e trajtimit të saj.



Me shumë zyrtarë janë të vetëdijshëm për nevojën për më shumë parashkollorë dhe qendra të kujdesit për fëmijët, kujdes për të moshuarit dhe kujdes për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht në zonat rurale

RrGK vazhdoi përpjekjet e saj avokuese drejt përmirësimit të disponueshmërisë së kujdesit ndaj fëmijëve, kujdesit për të moshuarit dhe kujdesit për personat me aftësi të kufizuara përmes të paktën shtatë iniciativave avokuese në vitin 2023. Kjo përfshiu dy takime të mbajtura në Bruksel me zyrtarët e BE-së, gjatë takimit të Nënkomitetit për Informacion dhe Politikën Sociale, lidhur me rekomandimet për Raportin e KE-së për Kosovën për vitin 2023, dhe në kuadër të PRE për 2023-2025. RrGK po ashtu ka avokuar që Ligji për Buxhetin të ndajë burime për mbështetjen e kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit. Duke shprehur shqetësimin për shtyrjen nga qeveria të projektligjit të punës, RrGK theksoi rëndësinë e dispozitave të kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit brenda kornizës më të gjerë legjislative.

Rritja e qasjes së grave në trashëgimi dhe pronësi përmes reformave ligjore, ndërgjegjësimit dhe ndihmës ligjore

Me mbështetjen e RrGK përmes FGK-së, organizata anëtare e RrGK-së Norma inicioi dhe dërgoi një letër të përbashkët autoriteteve përkatëse, duke avokuar që të drejtat e trashëgimisë dhe pronës së grave dhe vajzave të mbrohen në mënyrë adekuate përmes Kodit të ri Civil, ende në pritje për t'u miratuar. Gjithashtu, e mbështetur nga FGK-ja, Medica Kosova informoi 25 të mbijetuara të dhunës në familje për



procedurat ligjore për qasje në pronë dhe të drejta të tjera ligjore. Më pas, Medica Kosova ka ndihmuar gjashtë të mbijetuara të ndërmarrin veprime konkrete për regjistrimin e pasurisë së tyre në emrat e tyre ose në emrat e të dy bashkëshortëve.

Rritja e ndërgjegjësimit të zyrtarëve se si të përmirësohen kushtet e jetesës së grave rurale dhe grave me aftësi të kufizuara

Duke përdorur një qasje ndërsektoriale në avokimin e saj, RrGK ka dorëzuar komente për të paktën katër ligje dhe politika drejt përmirësimit të jetës së grave rurale dhe grave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë PRE për 2023-2025, projektligjin për shërbimet familjare dhe sociale, projektligjin për shëndetin riprodhues dhe Ligjin për buxhetin për vitin 2024.

Më shumë zyrtarë të institucioneve financiare ndërkombëtare janë të informuar për politikat e përgjegjshme gjinore

RrGK avokoi tek të paktën 16 zyrtarë në institucionet ndërkombëtare financuese për nevojën dhe strategjitë për politika financimi më të përgjegjshme ndaj gjinisë. RrGK ka avokuar për financim afatgjatë dhe fleksibil për OSHCG-të për të mbështetur punën e tyre strategjike.



Edukimi transformues gjinor

Objektivi i përgjithshëm i këtij programi është përmirësimi i qasjes në arsim cilësor që sfidon normat ekzistuese gjinore dhe marrëdhëniet e pushtetit. RrGK ka ndërmarrë hapa drejt arritjes së këtij objektivi të përgjithshëm, siç tregohet nga progresi në objektivat specifike të mëposhtme dhe rezultatet e pritura, të mbështetura nga ADA dhe Suedia.

Përmirësimi i teksteve shkollore dhe i mënyrës se si mësuesit i mësojnë kurrikulat me qëllim të arritjes së edukimit feminist transformues gjinor

Drejt këtij objektivi specifik të planifikuar për 2024-2025, RrGK në bashkëpunim me anëtarët e saj ka bërë progres drejt rezultateve të pritshme në vijim.

Rekomandimet ekzistojnë dhe u dërgohen akterëve përkatës për përmirësimin e mësimdhënies nga mësuesit dhe kurrikulat

Në vitin 2023, RrGK bëri progres drejt përmirësimit të kurrikulave dhe metodave të mësimdhënies nga perspektiva gjinore. Me mbështetjen e FGK-së, pesë anëtare të RrGK-së kryen hulumtime që përfshinin vëzhgimin në komuna të ndryshme për të kuptuar shkallën në të cilën arsimi ka një qasje transformuese



gjinore, duke kërkuar të identifikojnë mënyra për të ndryshuar rolet dhe stereotipet tradicionale gjinore. Pas marrëveshjeve me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe institucionet vendore, aktivistët vëzhguan ambientet e shkollave, klasat dhe mësimdhënësit për lëndët e përzgjedhura. Duke përdorur një metodologji të caktuar, kërkimi synonte të kuptonte shkallën në të cilën mjediset shkollore (infrastruktura ndërtimore), njohuritë e mësuesve, administratorëve dhe stafit, materialet mësimore, pedagogjia dhe pjesëmarrja e studentëve kontribuojnë në mjediset e të mësuarit transformues gjinor.

Së bashku me pesë organizata anëtare të RrGK-së, RrGK-ja vëzhgoi 10 shkolla në komunat e Prishtinës, Vushtrris, Pejës, Gjakovës dhe Drenasit. Janë vëzhguar gjithsej 43 lëndë mësimore lidhur me biologjinë, edukimin qytetar, edukimin fizik dhe gjuhën shqipe. Përveç kësaj, studiuesit kryen 14 intervista me mësuesit/et dhe një fokus grup me 10 mësues/e që japin mësim në psikologji, sociologji, gjuhë angleze, histori dhe edukim qytetar. Në vëzhgim është angazhuar edhe Qendra Burimore për Personat e Verbër në Pejë.

Pas përfundimit të hulumtimit, anëtarët e RrGK prezantuan gjetjet preliminare të hulumtimit përmes katër raporteve tek akterët përkatës komunal dhe hulumtuan strategji efektive drejt edukimit më transformues gjinor. Gjatë takimeve të avokimit, anëtarët e RrGK-së rekomanduan institucionet arsimore të integrojnë lëndë të specializuara në kurrikulë, duke adresuar drejtpërdrejt stereotipet gjinore që në moshë të re. Gjithashtu, ata theksuan rëndësinë e trajnimit të mësuesve mbi stereotipet gjinore, diskriminimin me bazë gjinore, dhunën dhe të drejtat e vajzave dhe grave. Gjithashtu avokuan për përditësimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore për të përfshirë përmbajtje që promovon



barazinë gjinore dhe sfidon në mënyrë aktive stereotipet dhe paragjykimet mbizotëruese. Për më tepër, ata rekomanduan organizimin e trajnimeve për mësuesit/et dhe stafin e shkollës për të rritur aftësitë e tyre në identifikimin, menaxhimin dhe raportimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, si dhe ofrimin e mbështetjes adekuate për viktimat. Gjithashtu, u nënvizua rëndësia e monitorimit dhe vlerësimit të ndikimit të ndërhyrjeve dhe politikave në lidhje me edukimin seksual dhe barazinë gjinore. Vlerësime të tilla janë jetike për të siguruar efektivitetin e këtyre nismave dhe për të bërë rregullime të informuara aty ku është e nevojshme.

RrGK ka filluar të konsolidojë dhe analizojë informacionin e mbledhur nga organizatat anëtare, drejt zhvillimit të një përmbledhjeje të politikave me rekomandime. Do të ndahet me MASHTI-n për të lehtësuar përpjekjet e vazhdueshme bashkëpunuese drejt edukimit më transformues gjinor.

Institucionet dhe mësuesit janë më përgjegjës për transformimin e normave gjinore gjatë mësimit të edukimit seksual në shkolla

Duke u bazuar në rekomandimet e dala nga hulumtimi, RrGK në bashkëpunim të ngushtë me MASHTI-n planifikon të iniciojë trajnime të synuara për mësuesit nga shkollat e përfshira në hulumtim në vitin 2024. Ajo do të përpiqet të rrisë aftësitë e edukatorëve, duke i fuqizuar ata të krijojnë mjedise të të mësuarit transformues gjinor.



Më shumë vajza, gra, djem dhe burra janë të vetëdijshëm për normat gjinore dhe feminizmin të arritura përmes materialeve të PR të RrGK-së

Në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit të vajzave, grave, djemve dhe burrave, RrGK promovoi rregullisht punën e saj dhe punën e anëtarëve të saj në ueb faqen e RrGK-së, faqen në Facebook, Twitter, Instagram dhe në buletin e saj mujor elektronik: Zëri i Gruas Kosovare. Në vitin 2023, RrGK kishte 149 paraqitje në media. RrGK rriti ndjekësit e saj në Facebook nga 24,805 në 2022 në 26,936 në 2023. Në Twitter numri i ndjekësve u rrit nga 1,544 në 1,552, dhe në Instagram nga 3,201 në 3,287, përkatësisht.



Qëllimi Ndërthurës: Fuqizimi i Lëvizjes Feministe

Ky objektiv i përgjithshëm ndërthurës synon të forcoj lëvizjen ekzistuese feministe në Kosovë, në rajon dhe më gjerë, përmes të gjitha programeve të RrGK. RrGK ka bërë progres drejt këtij objektivi të përgjithshëm, pasi ekziston Strategjia e RrGK-së që udhëzon përpjekjet drejt zgjerimit të punës së lëvizjes feministe, ku anëtarët e RrGK mbetën aktive përmes aktiviteteve të ndryshme, duke përfshirë tre takime të anëtarëve të RrGK të mbajtura në vitin 2023; dhe 11 gra dhe burra kanë mbështetur RrGK-në në vitin 2023. Ndërkohë, 2,595 gra Mbrojtëse të të Drejtave të Njeriut kanë marrë mbështetje nga RrGK përmes FKG-së. Është bërë përparim drejt këtij qëllimi afatgjatë në lidhje me objektivat specifike të mëposhtme dhe rezultatet e pritshme në titujt me shkronja të zeza më poshtë.

Rritja e solidaritetit dhe mirëqenies midis organizatave dhe grave aktiviste

RrGK vazhdoi partneritetin e saj ndëretnik në rajon përmes Koalicionit për Adresimin e Diskriminimit me Bazë Gjinore në Punë në Ballkanin Perëndimor (BP); partneritet me organizata për integrimin gjinor në procesin e anëtarësimit në BE përmes EQUAPRO; Rrjeti i Mbikëqyrjes së Buxhetit Gjinor (RrMBGJ) në BP dhe Republikën e Moldavisë, duke kërkuar të institucionalizoj buxhetimin e përgjegjshëm ndaj gjinisë; një rrjet organizatash që hulumtojnë financimin për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave; Rrjeti kundër dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave në BP, duke përfshirë OSHCG-të nga pesë vende në



përmirësimin e shërbimeve të rehabilitimit dhe riintegrit për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore; Lobi Evropian i Grave si anëtare mbështetëse; dhe RrGK iu bashkua rrjetit Gratë kundër dhunës në Evropë (WAVE) në vitin 2023. Për më tepër, RrGK ndërmori të paktën shtatë iniciativa të përbashkëta avokuese në bashkëpunim me OSHCG të tjera jashtë Rrjetit. Këto përfshinin: 1) takime përgatitore me OSHCG të tjera në rajon para Javës së Avokimit në Berlin të mbështetur nga Fondacioni Kvinna till Kvinna; 2) Javën e përbashkët e Avokimit në Berlin; 3) Takimet e përbashkëta në kuadër të Javës së Avokimit të BE-së, të mbështetura nga Fondacioni Kvinna till Kvinna; 4) përgatitjen e kontributit të përbashkët për Raportin e KE-së për Kosovën; 5) ofrimin e kontributit të përbashkët për draft Kodin Civil të Kosovës; 6) dërgimin e një letre reaguese të përbashkët lidhur me Projektligjin për Punën; 7) organizimin e një takimi të përbashkët me Kryeministrin e Kosovës z. Kurti, Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve z. Murati, Zëvendësministrin e Financave, Punës dhe Transfereve z. Dobruna dhe përfaqësues të tjerë të qeverisë për të diskutuar shqetësimet rreth Projektligjit për Punën dhe zbatimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Kosovë.

Më shumë gra, burra, vajza dhe djem të përfshirë në lëvizjen feministe

Në vitin 2023, RrGK angazhoi gjashtë vullnetarë dhe vullnetare. Kjo u dha atyre mundësinë që të bëhen më të ditur në organizimin, hulumtimin, avokimin, integrimin e vëmendjes ndaj barazisë gjinore në avokimin e të drejtave të njeriut, monitorimin e rasteve gjyqësore, për dhunën me bazë gjinore dhe për



çështje të tjera me të cilat përballen gratë në Kosovë. Përmes angazhimit të më shumë të rinjve, RrGK kërkon të forcojë më tej lëvizjen feministe në Kosovë.

Përmirësimi i kapaciteteve të anëtareve të RrGK-së, drejt qëndrueshmërisë së tyre

Pas granteve të dhëna për vitin 2023, RrGK kreu Vlerësimin Organizativ fillestar dhe Analizën e Kapaciteteve (VOAK) me të gjithë përfituesit e FGK-së për të vlerësuar ndryshimet në kapacitetet e tyre. Planet e përshtatura për zhvillimin e kapaciteteve janë krijuar dhe zbatuar me mbështetjen e RrGK-së, duke u fokusuar në fusha të tilla si marrëdhëniet me publikun, menaxhimi financiar dhe avokimi. Punëtoritë u organizuan gjithashtu për të rritur aftësitë në avokim, shkrimin e projekt propozimeve, mbledhjen e fondeve dhe të folurit publik. Për iniciativat e mbyllura, në fund RrGK kreu vlerësimin e dytë të VOAK për të matur progresin i cili është rritur ndjeshëm.

Rritja e kapaciteteve të stafit të RrGK

Stafi i RrGK-së mori pjesë në të paktën 16 aktivitete të ndryshme të zhvillimit të kapaciteteve në lidhje me burimet njerëzore, ndryshimet klimatike, Agjendën e Gjellbër, reformat e propozuara financiare nga Banka Botërore, kushtet e punës, financimin nga shteti i linjave ndihmëse SOS, New Gen(d)eration, dhe kontabilitetin digjital .



Përmirësimi i klimës së financimit për organizatat për të drejtat e grave

RrGK u përpoq të bënte progres drejt këtij objekti specifik afatmesëm, që do të matet në fund të periudhës aktuale strategjike të RrGK, përmes rezultateve të pritshme në vijim.

Përmirësimi i zbatimit të Strategjisë për Mobilizimin e Burimeve të RrGK-së

Mbledhja e fondeve përmes formave alternative është jetike për diversifikimin e burimeve dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të OSHC-ve. RrGK ka krijuar një strategji drejt mobilizimit të burimeve të ndryshme dhe ka ndërmarrë disa hapa drejt zbatimit. Për shembull, RrGK ka vazhduar koordinimin me OSHC-të e tjera drejt përmirësimit të kornizës ligjore dhe institucionale për filantropinë në Kosovë. Si pjesë e Forumit të Filantropisë, RrGK mori pjesë në disa takime për tejkalimin e pengesave në mbledhjen e fondeve për OSHC-të në Kosovë. Më 27 prill, përfaqësuesit e RrGK-së morën pjesë në një takim që mbledhi së bashku 14 pjesëmarrës nga sektorë të ndryshëm për të diskutuar problemet me të cilat përballen OSHC-të me shërbimet bankare dhe mundësitë për mbledhjen e fondeve online. Pjesëmarrësit ranë dakord të bashkëpunojnë në identifikimin e zgjidhjeve për këto pengesa.

RrGK vazhdoi të marrë pjesë në takimet e organizuara nga Këshilli për Bashkëpunim Qeveritar me Shoqërinë Civile në drejtim të koordinimit dhe monitorimit të zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023. Përfaqësueset/it e RrGK-së morën pjesë në grupet punuese të organizuara nga CiviKos me temë “Përmirësimi i kornizës institucionale për financimin e



qëndrueshmërisë së programeve dhe projekteve të OShC-ve në interes publik”. RrGK ka bashkëpunuar me OSHC-të e tjera për të avokuar mbi rëndësinë e krijimit të një linje buxhetore të mjaftueshme, transparente dhe të përhershme nga qeveria për mbështetjen e shoqërisë civile, drejt qëndrueshmërisë dhe elasticitetit të OSHC-ve në të ardhmen.

Në maj dhe qershor, RrGK organizoi dhjetë sesione mentorimi për grantmarrësit e FGK-së në drejtim të rritjes së kapaciteteve dhe elasticitetit të tyre, veçanërisht pas pandemisë COVID-19. Mbështetur nga BE-ja, seancat e mentorimit u zhvilluan me strehimoret në Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren, Gjakovë dhe Pejë, si dhe me tre organizata të tjera dhe Qendrën për Arsim dhe Miq të Zhvillimit të Komunitetit. Stafi i RrGK prezantoi përfituesit e granteve në Strategjinë e Mobilizimit të Burimeve të RrGK-së dhe i ndihmoi ata të identifikonin rrugë të reja për diversifikimin e burimeve të tyre, hartimin e burimeve të komunitetit, sigurimin e fondeve shtesë dhe rritjen e qëndrueshmërisë së tyre.

Më 16 mars, stafi i RrGK-së mbajti trajnim në Prizren me temën “Diversifikimi i burimeve dhe mbledhja e fondeve”, organizuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile. Ky trajnim bazë kishte për qëllim rritjen e kapaciteteve të OShC-ve dhe aktivistëve vendorë për modele të ndryshme për mbledhjen e fondeve për të mbështetur punën e tyre. Përafërsisht 13 pjesëmarrës (pesë gra dhe tetë burra të etnive të ndryshme dhe zonave rurale/urbane) nga OSHC të ndryshme në Prizren morën pjesë. Fushat e ndryshme të fokusit të pjesëmarrësve përfshinin avancimin e barazisë gjinore, arsimin, mbështetjen e grupeve të marginalizuara, mbrojtjen e mjedisit, efikasitetin e energjisë, rininë dhe pajtimin. Pjesëmarrësit morën njohuri të reja për hartimin e donatorëve të mundshëm dhe identifikimin e modeleve të ndryshme



të mbledhjes së fondeve. Të gjitha këto përpjekje kontribuan në progresin drejt zbatimit të Strategjisë për Mobilizimin e Burimeve të RrGK-së.

Njohuri dhe mirëkuptim i përmirësuar midis donatorëve përkatës në lidhje me llojet e mbështetjes për të cilat kanë nevojë OSHCG- të e ndryshme

Në bashkëpunim të ngushtë me organizatat partnere në rajon, RrGK informoi përafërsisht dhjetë përfaqësues të organizatave të ndryshme financuese për nevojat e ndryshme të financimit të OSHCG-ve, përfshirë gjatë avokimit ndaj qeverisë gjermane në kontekstin e politikës së jashtme feministe, si dhe në avokimin ndaj BE-së, të gjitha të mbështetura nga Fondacioni Kvinnat till Kvinna.



Qëllimi ndërthurës: Mbrojtja e Mjedisit

Objektivi i përgjithshëm i këtij synimi ndërthurës është të përmirësojë shkallën në të cilën gjinia, duke përfshirë nevojat dhe interesat e ndryshme të grave dhe burrave të ndryshëm, reflektohen në politikat mjedisore dhe planifikimin urban, në përputhje me PVGJ III të BE-së. RrGK ka bërë disa përparime fillestare drejt këtij objektivi në vitin 2023 duke ofruar të dhëna në lidhje me Planin e Veprimit III të Instrumentit të Para-Aderimit (IPA) të BE-së për Ndryshimet Klimatike dhe Mjedisin. Staf i RrGK-së gjithashtu ndoqi trajnimin dhe vazhdoi njohuritë e tyre për t'u përgatitur për një analizë gjinore në lidhje me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe ndryshimet klimatike, të planifikuar për vitin 2024. Bazuar në analizat, RrGK planifikon të ndër marrë avokim të bazuar në dëshmi drejt ligjeve dhe politikave më të përgjegjshme gjinore që lidhen me ndryshime klimatike.



Raporti financiar i RrGK-së për vitin 2023

Tabela e mëposhtme përmbledh të ardhurat dhe shpenzimet e RrGK-së në vitin 2023. Për prezantim më të thjeshtë, të gjithë numrat janë rrumbullakosur në euron e plotë të afërt. Gjendja e mbetur do të bartet në vitin 2024.

Donatori (Periudha e zbatimit)	Titulli i nismës	Fondet nga viti 2022	Fondet e pranuar në vitin 2023	Gjithsej të ardhura	Shpenzimet	Bilanci
Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) 8299-00/2021, dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida) 14853 (01.03.2021-28.02.2025)	Avancimi i mëtejshëm i të drejtave të grave në Kosovë II	364,851	130,000	494,851	208,811	286,040
Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë	Fuqizimi i Pjesëmarrjes së Grave në Politikë (projekt i përfunduar)	-	7,687	7,687	7,687	-



Donatori (Periudha e zbatimit)	Titulli i nismës	Fondet nga viti 2022	Fondet e pranuar në vitin 2023	Gjithsej të ardhura	Shpenzimet	Bilanci
2018/404-465 (20.12.2018-20.12.2022)) dhe Fondi Sigrid Rausing Trust						
Zyra e Bashkmit Evropian në Kosovë dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida), përmes REACTOR: 2019/414-028 (01.03.2020-28.02.2024)	Avancimi i barazisë gjinore përmes procesit të Anëtarësimit në BE	13,823	55,432	69,256	53,128	16,128
Zyra e Bashkmit Evropian në Kosovë 2021/426-885 (01.09.2021-30.06.2023) dhe Fondacioni Kvinna till Kvinna	Rritja e Kapaciteteve dhe Qëndrueshmërisë së OshC-ve për përparimin e Barazisë Gjinore në mes të Pandemisë COVID-19	188,980	23,612	212,592	212,592	-


Donatori (Periudha e zbatimit)	Titulli i nismës	Fondet nga viti 2022	Fondet e pranuar në vitin 2023	Gjithsej të ardhura	Shpenzimet	Bilanci
Fondacioni Kvinna till Kvinna: KO01SID34-31009 and KO01RAM03-31009 (01.01.2021-31.12.2023)	Mbështetje Institucionale	45,864	70,011	115,875	115,875	-
Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida) përmes CRPM: 2841-00/2022 (01.11.2022-30.10.2026)	Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies për barazinë gjinore në Ballkanin Perëndimor dhe Moldavi (Rrjeti Mbikëqyrës i Buxhetit Gjikor, Faza II)	52,382	-	52,382	30,269	22,112
UN Women: 00119636 (01.09.2021-01.03.2023)	Përmirësimi i kapaciteteve organizative të strehimoreve në trajtimin e dhunës seksuale duke përfshirë gratë nga minoritetet	15,343	15,154	30,496	30,496	-

Donatori (Periudha e zbatimit)	Titulli i nismës	Fondet nga viti 2022	Fondet e pranuar në vitin 2023	Gjithsej të ardhura	Shpenzimet	Bilanci
Fondi Sigrid Rausing Trust (01.06.2022-31.05.2025)	Mbështetje Institucionale	88,900	183,387	272,287	158,070	114,216
Ambasada kanadeze: 2023-ZAGRB-Kosovo-0020 (01.08.2023-28.02.2024)	Përmirësimi i trajtimit për viktimat e dhunës seksuale përmes avokimit me qëllim të avancimit të kornizës ligjore dhe ngritjes së kapaciteteve për mekanizmat koordinues komunalë	-	20,025	20,025	20,025	-
Fondi i Kombeve të bashkuara për Zhvillim - UNDP (22.12.2022-10.02.2023)	Përfshirja e perspektivës gjinore - Shqyrtimi gjinor i portfoliove 2022-RLA-002	-	10,218	10,218	10,218	-
Fondacioni Zemra dhe Dora	Mbështetje e përgjithshme	6,824	-	6,824	6,824	-
Altrusa	Fondi i qëndrueshmërisë	881	1,817	2,698	881	1,817

Donatori (Periudha e zbatimit)	Titulli i nismës	Fondet nga viti 2022	Fondet e pranuar në vitin 2023	Gjithsej të ardhura	Shpenzimet	Bilanci
Donacione për RrGK	Fondi i qëndrueshmërisë	15,804	87,446	103,251	729	102,521
Gjithsej		793,652	604,788	1,398,440	855,605	542,835



SHPËRNDARJA E SHPENZIMEVE PËR VITIN 2023





Str. e Rilindjes
Kolon Tower, Floor 11, No.110
Prishtine
T: +383 48 211 687
E: info@acaonline.com
W: acaauditing.com

INDEPENDENT AUDITOR'S REPORT

To the Management of Kosovo Women's Network

Opinion

We have audited the accompanying financial statements of Kosovo Women's Network, which comprise the statement of financial position as at December 31, 2023 and the statement of profit or loss, statement of changes in fund balances and statement of cash flow for the year then ended, and other explanatory notes.

In our opinion, the financial statements referred to above present fairly, in all material respects, the financial position of Kosovo Women's Network as of December 31, 2023, results of its operation and the cash flow for the year then ended in conformity with actual laws.

Basis for Opinion

We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing (ISAs). Our responsibilities under those standards are further described in the Auditor's Responsibilities for the Audit of the Project financial report section of our report. We are independent of the Business in accordance with International Ethics Standards Board for Accountants Code of Ethics for Professional Accountants (IESBA Code), and we have fulfilled our other ethical responsibilities in accordance with these requirements. We believe that the audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our opinion.

Responsibilities of Management and those charged with Governance for the financial statements

Management is responsible for the preparation and fair presentation of these financial statements in accordance with the international Financial Reporting Standard and the internal controls that the management deems necessary to enable the preparation of financial statements without material misstatement due to fraud or error.

For the financial statements preparation, management is responsible for assessing the organization's ability to sustainability in the future, disclosing, as necessary, future sustainability issues and using the accounting continuity principle unless management intends to liquidate the Organization or interrupt the operation, or there is no other possible alternative than to do it.

Those charged with governance are responsible for overseeing the Organization's financial reporting process.

Auditor's Responsibilities for the Audit of the financial statements

Our objectives are to obtain reasonable assurance about whether the financial statements as a whole are free from material misstatement, whether due to fraud or error, and to issue an auditor's report that includes our opinion. Reasonable assurance is a high level of assurance, but is not a guarantee that an audit conducted in accordance with ISAs will always detect a material misstatement when it exists.



Misstatements can arise from fraud or error and are considered material if, individually or in total, they could reasonably be expected to influence the economic decisions of users taken on the basis of these financial statements.

As part of an audit, in accordance with ISAs, we exercise professional judgment and maintain professional skepticism throughout the audit. We also:

- Identify and assess the risks of material misstatement of the financial statements, whether due to fraud or error, design and perform audit procedures responsive to those risks, and obtain audit evidence that is sufficient and appropriate to provide a basis for our opinion. The risk of not detecting a material misstatement resulting from fraud is higher than for one resulting from error, as fraud may involve collusion, forgery, intentional omissions, misrepresentations, or the override of internal control.
- Obtain an understanding of internal control relevant to the audit in order to design audit procedures that are appropriate in the circumstances, but not for the purpose of expressing an opinion on the effectiveness of the Organization's internal control.
- Evaluate the appropriateness of accounting policies used and the reasonableness of accounting estimates and related disclosures made by management.
- Conclude on the appropriateness of management's use of the going concern basis of accounting and, based on the audit evidence obtained, whether a material uncertainty exists related to events or conditions that may cast significant doubt on the Organization's ability to continue as a going concern. If we conclude that a material uncertainty exists, we are required to draw attention in our auditor's report to the related disclosures in the financial statements or, if such disclosures are inadequate, to modify our opinion. Our conclusions are based on the audit evidence obtained up to the date of our auditor's report. However, future events or conditions may cause the Organization to cease to continue as a going concern.
- Evaluate the overall presentation, structure and content of the financial statements, including the disclosures, and whether the financial statements represent the underlying transactions and events in a manner that achieves fair presentation.

We communicate with those charged with governance regarding, among other matters, the planned scope and timing of the audit and significant audit findings, including any significant deficiencies in internal control that we identify during the audit.


Astrit Trusa – Statutory Auditor
ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtine, Kosovo
March 15, 2024



Rreth nesh

Bordi i Drejtoreve të RrGK

Ariana Qosaj Mustafa, Ligjëruese në AUK/RIT, Aktiviste për të Drejtat e Grave (Kryetare e Bordit)
Feride Rushiti, Drejtore Ekzekutive e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës
Shqipe Malushi, Aktiviste për të Drejtat e Grave
Vjosa Dobruna, Aktiviste për të Drejtat e Grave
Zana Hoxha, Drejtore Ekzekutive, Artpolis
Belgjzare Muharremi, Anëtare nderi

Bordi Këshillëdhënës i RrGK

Behar Selimi, Delina Fico, Lepa Mladjenovic, Marte Prekpalaj, Rachel Wareham

Anëtarët e stafit të RrGK-së në 2023

Ekipi Menaxhues

Igballe (Igo) Rogova, Drejtore Ekzekutive
Nicole Farnsworth, Drejtore e Programit dhe Udhëheqëse e Hulumtimit



Besa Shehu, Drejtore Financiare dhe Administrative
Adelina Berisha, Menaxhere e Programit për Adresimin e Dhunës në Bazë Gjinore
Donjetë Berisha, Menaxhere e Fondit të Grave të Kosovës
Zana Rudi, Menaxhere e Programit
Alba Loxha, Menaxhere për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Komunikim

Programi për Sundimin e Ligjit

Valmira Rashiti, Zyrtare për Integrim të Perspektivës Gjinore
Etleva Malushaj, Zyrtare e Programit
Elirjeta Beka, Koordinatore e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor
Eleta Shala, Hulumtuese
Edita Bllaca, Hulumtuese
Ernera Dushica, Koordinatore e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor (deri nëmuajin shkurt)
Aurora Maxharraj, Hulumtuese

Programi për Adresimin e Dhunës me Bazë Gjinore

Besarta Breznica, Koordinatore e Programit
Erin Brown, Vullnetare (Janar- Qershor)
Viona Krasniqi, Monitoruese, Asistente ligjore



Programi për Fuqizimin Ekonomik të Grave

Adelina Tërshani, Zyrtare e Programit për Fuqizimin Ekonomik të Grave dhe BPGj

Fondi i Grave të Kosovës

Arbenita Kllokoqi, Zyrtare për Financa (nga muaji qershor)

Desumena Laçi, Menaxhere financiare

Valbona Nuredini, Zyrtare për Financa (deri në muajin dhjetor)

Drita Sylejmani, Koordinatore e Projektit

Laurita Morina, Koordinatore e Projektit

Eranda Gashi, Koordinatore e Projektit

Marrëdhëniet me Publikun dhe Komunikimi

Albana Isufi Jashanica, Koordinatore për Marrëdhënie me Publikun

Ariana Kasapoli Selani, Koordinatore për Marrëdhënie me Publikun

Hana Murati, Praktikante për Marrëdhënie me Publikun (korrik-dhjetor)

Loreta Suka, Përkthyesë

Arjeta Murati, Përkthyesë

Stafi administrativ

Luljeta Mehmeti Osmaj, Menaxhere Financiare



Mimoza Gojani Grezda, Zyrtare për Financa/Kontabiliste
Mirjeta Dibrani, Koordinatore për Anëtarësi dhe Administratë
Jehona Tupalla, Mirëmbajtje, Logjistikë dhe Asistente Shoferi

Kontributet Individuale për RrGK

Personat e mëposhtëm dhanë kontribute individuale për të mbështetur punën e RrGK-së: Barbra Bearden, Dennis and Katharine Luster, Elizabeth Kohnen, Elisabeth Kaestli, Frank dhe Sue Farnsworth, Jimmy Vestin, Melihat Bajram Beshiri, Noah Pearson, Oliver Dominic Samter, Thomas Sadoski, Vigan Hoxha dhe Valbone Adem Sadiku.



Organizatat Anëtare të RrGK

#	Organizata	Adresa	Përfaqësuesja/i
1	Aksioni për Nëna dhe Fëmijë	Rr. Perandori Dioklecian, Nr. 14, Tophane, Prishtinë	Vlorian Molliqaj
2	Alma	Rr. Shpëtim Bojku, Nr.1, Pejë	Shemsije Seferi
3	Arta	Rr. Vetërniku I, Behar Begolli, Nr.23, Prishtinë	Hafije Qyqalla
4	Arti pa limit (AWL)	Rr. Hyzri Talla, nr.H5/7, Bregu i diellit, 10000 Prishtinë	Ganimete Sava
5	Artpolis	Rr. Shaban Polluzha, P.n., Prishtinë	Zana Hoxha
6	Assist Qendra Kosovare - ASSIST	Prishtinë	Visare Berisha
7	Asociacioni i Gruas Feminae AGF	Adem Jashari 124/8, Prizren	Shykran Berisha
8	ATO	Rr. Wesli Clark Pn, Vushtrri	Fikrije Ferizi
9	Aureola	Kompleksi Avalla, B/I, Nr.4, Prishtinë	Sanije Grajçevci
10	Bashkimi Rinor e Ardhmja e Ndritur "BRAN"	Rrruga Sejdi Sejdiu pn. Ferizaj	Gyltene Osmani Ilazi



#	Organizata	Adresa	Përfaqësuesja/i
11	Begatit e Batllavës	Fshati Batllave, Komuna Podujeve	Magbule Statovci
12	Bliri	Rr. Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Drenas	Mahije Smajli
13	Bleta e Pejës	Pejë Bellopoj Dimitrije Tucovic	Arlinda Kastrati
14	Gratë afariste Mitrovicë	Qendra e Kulturës, kati 5, Mitrovicë	Melihat Beshiri
15	Qendra për Edukim dhe Zhvillim Komunitar - Miq	Qendra e Kulturës, Kati i II-të, Mitrovicë	Valbona Sadiku
16	Qendra Komunitare e Minoriteteve	s. Laplje Selo, Gračanica	Jelena Bulatović
17	Dera e Hapur	Tringë Smajli, Nr. 72, Prishtinë	Belgizare Muharremi
18	Dita	Prishtinë	Afërdita Zeneli
19	Down Syndrome Kosova	Rr.Ukshin Hoti, Pejton, Prishtine	Sebahate Beqiri
20	Drugëza	Rr. Adem Jashari, Skenderaj	Hana Zabeli
21	Duart e Vyera "Dora"	Lipjan	Mihane Avdullahu
22	EcoKosWomen EKW	Rr. Hilmi Rakovica nr.31, 10000 Prishtinë	Magbule Hyseni

#	Organizata	Adresa	Përfaqësuesja/i
23	Kodi arsimor	Prishtinë	Mimoza Stanovci
24	Elita - Centre for Education and Development	Lipjan	Luljeta Krasniqi Murati
25	EMINA - Grupi i Grave Boshnjake	Rr. 7 Shtatori, Jakup Ferri, Mitrovicë	Fata Zatriqi
26	Era Fruit	Batllavë, Podujevë	Xhyllie Statovci
27	EULOC - Organizata për Reforma Lokale	Shtëpia e Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani", Viti	Melihate Osmani (e autorizuar)
28	FANA	Rr. Zhuj Selmani, Nr. 103, Pejë	Fane Gashi
29	Femra Vizionare e Shekullit XXI	Fsh. Bregdrini, Has, Prizren	Marte Prekpalaj
30	Femrat Aktive të Gjakovës	Rr. Sulejman Vokshi, Nr. 1, Gjakovë	Valbona Doli Rizvanolli
31	Flaka	Rr. Skenderbeu, Lipjan	Melihate Dedushi
32	Flori	Henc, Fushë Kosovë	Hava Abdullahu
33	Foleja	Zahir Pajaziti, Nr. 9, Zyrja Nr. 5, Prizren	Gjyzel Shaljani



#	Organizata	Adresa	Përfaqësuesja/i
34	Fondacioni për Edukim dhe Zhvillim (F.E.ZH.)	Bregu i Diellit - Zona e Lindjes, Ll. 12, Nr. 7, Prishtinë	Vjollca Zeqiri
35	Forumi Demokratik i Gruas (FDG)	Rr. Mbretëresha Teutë, Nr. 103, Pejë	Myzafere Ibishaga
36	Zëri i grave të Parteshit	Parteš	Vesna Dimić
37	Gratë e Bashkura për Sukses (GBPS)	Rr. Kadri Zeka Nr. 31, Prishtinë	Zejnebe Hasani
38	Gruaja Fermere	Rahovec	Habibe Haxhimustafa
39	Gruaja Hyjnore	Rr. Sadullah Brestovci, Gjilan	Igballe Hajdari
40	Handikos Mitrovica	Mitrovicë	Myrvete Hasani
41	HANDIKOS, Femrat me Aftësi të Kufizuara	Dardania B 1/5, Prishtinë	Mehreme Llumnica
42	Have Hope- Kam Shpresë	Emin Duraku, Prishtinë	Arnisa Osmani
43	Hendifer	Rr. Ramadan Rexhepi, Nr. 1, Ferizaj	Fazile Bungu
44	Humanus Vita	Dardani, Prishtinë	Doruntina Gashi
45	Iniciativa e Femrës Kosovare	Gjakovë	Leonora Kalludra
46	Iniciativa e Pavarur e të Verbërve	Dardani, Prishtinë	Fatbardha Salihu



#	Organizata	Adresa	Përfaqësuesja/i
47	Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK)	Fshati Sfaraqak, Vushtrri	Zenel Bunjaku
48	Instituti Kosovar i Medias dhe Komunikimit - IKMK	Rruga B, nr.210, 10000 Prishtinë	Kaltrina Ajeti
49	IPKO Foundation	Prishtinë	Abetare Gojani
50	JETA	Deçan	Safete Gacaferri
51	Jeto Vepro dhe Krijo JVK	Rr.Njazi Azemi Nr 58 Prishtinë	Sabrije Basha
